

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 64812  
E hënë, 6 dhjetor 2021  
çmimi 0.40

## Në Prishtinë protestohet kundër dhunës ndaj grave



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# VDES MIKU I MADH I KOSOVËS, SENATORI BOB DOLE



QEVERIA E KOSOVËS KA SHTRËNGUAR MASAT KUNDËR PANDEMISË COVID-19

# SOT HYJNË NË FUQI MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT



Nga sot (e hënë) hyjnë në fuqi masat e reja kundër Covidit. Sipas masave të reja, qeveria ka vendosur që qytetarët të cilët hyjnë në Kosovë duhet ta kenë dëshminë e vaksinimit të plotë, testin negativ apo dëshminë se e kanë kaluar Covid-19. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije të dielën se këto masa janë përgjigje ndaj situatës së fundit të krijuar nga pandemia

NË ZGJEDHJET LOKALE VOTUAN 46 PËR QIND E MESHKUJVE DHE 38 PËR QIND E FEMRAVE

KURTI: NË JAVËN E DYTË TË DHJETORIT MUND TË NDODHË TAKIMI ME VUÇIQIN

## AKTUALE



PARTIA ALTERNATIVA BËHET PJESË E QEVERISË SË MAQEDONISË SË VERIUT

NJË MUAJ PARABURGIM PËR PERSONAT E ARRESTUAR NË RASTIN "SUBVENCIONET"

NIS MOBILIZIMI I BASHKËSIVE FETARE PËR VAKSINIM

## EKONOMI



KOSOVA, E VETMJA NË RAJON PA REZERVË TË ARIT

## SPORT



DRITA FITON DERBIN NË 'FADIL VOKRRI', BALLKANI RUAN POZITËN E PARË

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOV.  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Vdes miku i madh i Kosovës, senatori Bob Dole

Ish-senatori amerikan, Bob Dole, vdiq të dielën në moshën 98-vjeçare, njoftoi familja e tij.

"Senatori Robert Joseph Dole vdiq në gjumë, mëngjesin e sotëm".

"Ai u ka shërbyer me besnikëri Shteteve të Bashkuara të Amerikës për 79 vjet", tha familja e tij përmes një deklarate.

Në muajin shkurt të këtij viti, senatori Dole ka njoftuar se është diagnostikuar me kancer në mushkëri.

"Kam disa vështirësi përpara, por gjithashtu e di se iu bashkohem miliona amerikanëve që përballen me sfida të konsiderueshme shëndetësore", ka thënë atëbotë Dole.

Ai ka kaluar një çerek shekulli në Senatin amerikan, ku, për disa vite, ka shërbyer si udhëheqës i shumicës.

Në vitin 1996 ka qenë kandidat i Partisë Republikane për president të SHBA-së, por ka humbur kundrejt demokratit Bill Clinton.

Ai ka kërkuar nominimin presidencial të partisë së tij

edhe në vitin 1980 dhe në vitin 1988, ndërsa ka qenë kandidat për zëvendëspresident në vitin 1976.

Në vitin 1990, Dole ka udhëhequr një delegacion të SHBA-së në Kosovë, ndërsa në gusht të vitit 2020, për nder të angazhimit të tij për Kosovën, busti i tij është vendosur në Prishtinë.

Në atë kohë, përmes një video-mesazhi, Dole ka shprehur mirënjohjen për inaugurimin e bustit.

"Më vjen keq që nuk mund të jem me ju në inaugurimin e bustit, më kujton kohën e para 30 vjetëve. Tridhjetë vjet kemi punuar për të krijuar një shtet të fortë dhe shpresoj se do të vazhdoni të punoni për t'u bërë edhe më të fortë", ka thënë Dole.

Në një postim në Twitter, më 30 gusht të vitit 2020, Dole ka shkruar:

"Tridhjetë vjet më parë, unë dhe kolegët e mi kemi udhëtuar për herë të parë në Prishtinë. Askush nga ne nuk mund ta dinte se ky do të ishte fillimi i një



rrugëtimi drejt pavarësisë për popullin e Kosovës".

Më 30 nëntor, Dole ka bërë postimin e fundit në Twitter për Kosovën, duke paralajmëruar një program të Institutit Dole për historinë e Kosovës.

"Zoti e bekoftë Amerikën dhe Zoti e bekoftë Kosovën", ka shkruar Dole.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, shprehu pikëllimin e saj për vdekjen e senatorit Dole, të cilin e përshkroi si "hero luftime, politikan të respektuar dhe mbështetës të lirisë në të gjithë botën". "Në veçanti jemi mirënjohës që ai gjithmonë ka qëndruar pranë popullit të Kosovës në luftën tonë për pavarësi",

shkroi Osmani në Twitter. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përmes një postimi në Twitter tha se ish-senatori Dole ishte një "përkrahës crucial i lirisë së Kosovës", teksa i shprehu ngushëllime familjes Dole dhe popullit amerikan për ndarjen nga jeta të ish-senatorit, Bob Dole.

## Partia Alternativa bëhet pjesë e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut

**SHKUP, 5 DHJETOR** - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe kryetari i Alternativës, Afrim Gashi, kanë nënshkruar të dielën marrëveshjen zyrtare për hyrjen e Alternativës në Qeveri.

Zaev ka thënë se kjo marrëveshje nënshkruhet për të pasur një qëndrueshmëri politike për t'i hapur negociatat me BE-në, bisedimet me Bullgarinë dhe për të vazhduar luftën kundër Covid-19.

Ai ka treguar se Alternativa do të drejtojë tri ministri.



"Alternativa do ta emërojë ministrin e Shëndetësisë, ministrin për Shoqëri

Informatike dhe Administratë dhe një ministër pa resorë për Diasporën. Gjithashtu, do të

ketë tre zëvendësministra", ka deklaruar Zaev.

Afrim Gashi ka thënë se vendimi i Alternativës nuk ishte i lehtë, por shtoi se të gjithë faktorët kyç që janë marrë parasysh, kanë bërë, sipas tij, që partia që ai drejton, të bëhet pjesë e shumicës parlamentare dhe qeverisë.

Gashi ka pohuar se partia e tij nuk dëshironte që Maqedonia e Veriut të futej në krizë institucionale, por edhe t'ua jepte shansin negociatave me Bullgarinë për zgjidhjen e kontestit dhe këtë, sipas tij, mund ta bëjnë vetëm se

institucionet stabile dhe funksionale. "Gjashtëdhjetë e katër deputetë do të jenë pjesë e shumicës parlamentare dhe kjo do të punojë për të dalë nga kriza shëndetësore, ekonomike dhe energjetike që po e ndiejmë. Nuk ishte e lehtë për të marrë një vendim të tillë, por shumica e argumenteve ishin që Alternativa të vendoste për rrugën që po ndjek sot. Gjatë negociatave jemi mbështetur në dy shtylla. E para është pjesa programore dhe e dyta për marrjen e përgjegjësisë të Alternativës në ekzekutiv", ka theksuar Gashi.

## Izraeli kërkon qasje më të ashpër ndaj Iranit në bisedimet bërthamore

**JERUSALEM, 5 DHJETOR** - Kryeministri i Izraelit, Naftali Bennett, më 5 dhjetor u bëri thirrje fuqive perëndimore që të kenë një qëndrim më të ashpër ndaj Iranit në bisedimet për ta frenuar

programin bërthamor të Teheranit. Këto komente ai i bëri teksa zyrtarët kryesorë izraelitë të mbrojtjes dhe inteligjencës janë nisur në Uashington, pas dështimit të bisedimeve për

marrëveshjen bërthamore të Iranit.

Izraeli ka shikuar me shqetësim teksa fuqitë perëndimore u takuan me Iranin për të biseduar për marrëveshjen bërthamore të

vitit 2015. Në raundin e ri të bisedimeve që u mbajtën këtë javë në Vjenë të Austrisë, Irani sugjeroi se gjithçka që është diskutuar në raundet paraprake duhet të rinegociohen. Irani, po ashtu,

nuk po ngadalëson përparimet në programin e tij bërthamor, duke vënë edhe më tej në rrezik bisedimet, që shihen si vendimtare për uljen e tensioneve në Lindjen e Mesme dhe më gjerë.



## Në Prishtinë protestohet kundër dhunës ndaj grave

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Me moton "Boll ma! Asnjë grua e vajzë më pak, asnjë vdekje më shumë!", organizata joqeveritare "Artpolis" mbajti të dielën, më 5 dhjetor, një protestë në Prishtinë kundër dhunës ndaj grave.

Protestueset, të veshura me rroba të bardha dhe me shenja dhune të improvizuara në fytyrë, marshuan në sheshet kryesore të Prishtinës, për t'u ndalur para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, ku vendosën në tokë një pllakate me moton e kësaj proteste.

Organizatorët e kësaj proteste thanë se po kërkojnë drejtësi për vajzat dhe gratë e abuzuara në familje dhe shoqëri si dhe drejtësi për ato që humbën jetën

si pasojë e dhunës në familje.

Udhëheqësja e organizatës "Artpolis", Zana Hoxha, tha se abuzimi sistematik i vajzave dhe grave dhe vdekjeve të tyre si pasojë e dhunës po ndodh edhe për shkak të mungesës së përgjigjes së duhur institucionale për parandalimin dhe "ndarjen e dënimeve të merituar për kryerësit e këtyre veprave".

Në Kosovë gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës në familje.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, deri në shtator të vitit 2021 viktimat e dhunës në familje janë raportuar se kanë qenë 1 437 gra dhe 408 burra.

Çdo vit, që nga 2018-ta, së paku 1 000 gra janë raportuar viktimat e dhunës në familje.

Më 25 nëntor u shënuar Dita



Ndërkombëtare për Ndalimin e Dhunës ndaj Grave dhe që nga kjo datë, për 16 ditë, ndryshme kundër dhunës ndaj grave. Organizohen aktivitetet të grave.

## Një muaj paraburgim për personat e arrestuar në rastin "Subvencionet"



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë më 5 dhjetor caktoi masën e paraburgimit prej një muaji për 31 të arrestuar lidhur me rastin e njohur si "Subvencionet". Përmes një njoftimi për media, gjykata tha se të pandehurit dyshohen për veprat penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Marrje e ryshfetit", "Falsifikim i dokumentit zyrtar" dhe "Mashttrim me subvencione". Të premten, më 3 dhjetor, Policia e Kosovës gjatë një aksioni në

rajone të ndryshme të Kosovës, arrestoi 31 persona, përfshirë 12 zyrtarë me pozita të ndryshme nga komunat dhe zyrat rajonale të Agjencisë Zhvillimore të Bujqësisë dhe Zyrës Rajonale të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës. Aksioni i 3 dhjetorit ishte vazhdimësi e disa aksioneve të kryera më herët gjatë vitit ndaj zyrtarëve që dyshohen për keqpërdorim të subvencioneve. Gjykata Themelore e Prishtinës njoftoi se 31 të pandehurit mund të ushtrojnë ankesë për masën e paraburgimit.

## Në zgjedhjet lokale votuan 46 për qind e meshkujve dhe 38 për qind e femrave

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Në zgjedhjet lokale të 17 tetorit meshkujt dolën më shumë për të votuar në krahasim me femrat. Ky konstatim mbështetet në të dhënat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje sipas gjinisë.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka deklaruar për "KosovaPress" se rreth 46 për qind e votuesve meshkuj të regjistruar morën pjesë në votime, ndërsa shifra e pjesëmarrjes së femrave është më e ulët pasi, sipas të dhënave të KQZ-së, vetëm rreth 38 për qind e votuesve femra dolën për të votuar më 17 tetor.

Sipas listës përfundimtare të votuesve, numri i qytetarëve me të drejtë vote në zgjedhjet e tetorit ishte 1 milion e 885 mijë e

448 votues, prej të cilëve rreth 968 mijë ishin votues meshkuj, ndërsa femra ishin rreth 918 mijë votuesve. "Duke u mbështetur në të dhënat e pjesëmarrjes në zgjedhje, nga rreth 968 mijë votues meshkuj kanë votuar rreth 46 për qind e tyre apo rreth 443 mijë votues, ndërsa nga rreth 918 mijë votuese të regjistruara, kanë votuar rreth 38 për qind apo gati 345 mijë votuese", ka deklaruar Elezi.

Elezi ka treguar se jo vetëm në këtë proces zgjedhor, por edhe në tërë proceset e tjera zgjedhore që nga viti 2009, pjesëmarrja në votime ka qenë gati gjithmonë më e lartë te meshkujt, me përjashtim të zgjedhjeve lokale në vitin 2013.

Për zgjedhjet lokale që u mbajtën më 17 tetor, KQZ-ja kishte



certifikuar 89 subjekte politike dhe rreth 5 370 kandidatë, prej të cilëve 166 kandidatë për kryetarë

të komunave, kurse pjesa tjetër kandidatë për kuvende komunale. Nga ky numër

kandidatësh, më shumë se 3 400 ishin kandidatë meshkuj, ndërsa vetëm 1 951 femra.





QEVERIA E KOSOVËS KA SHTRËNGUAR MASAT KUNDËR PANDEMISË COVID-19

# Sot hyjnë në fuqi masat e reja kundër Covidit

Nga sot (e hënë) hyjnë në fuqi masat e reja kundër Covidit. Sipas masave të reja, qeveria ka vendosur që qytetarët të cilët hyjnë në Kosovë duhet ta kenë dëshminë e vaksinimit të plotë, testin negativ apo dëshminë se e kanë kaluar Covid-19. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije të dielën se këto masa janë përgjigje ndaj situatës së fundit të krijuar nga pandemia

mërgimtarëve. Shtimi i numrit të udhëtarëve rrit mundësinë që gjendja epidemiologjike të jetë e ngjashme. Kosova ka shkallë më të ulët të vaksinimit se këto vende evropiane. Dhe, së katërti, ditët e fundit është shfaqur në Afrikën e Jugut një variant i ri i virusit korona, 'Omicron'. Ky variant është

përhapur në së paku 38 vende të botës", ka thënë Kurti.

Kurse ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka bërë thirrje për vaksinim të qytetarëve si masë mbrojtëse kundër koronavirusit. "Në këtë drejtim të gjithë personat që hyjnë duhet ta kenë certifikatën e vaksinimit të plotë, nëse

personi ka vetëm një dozë, do të kërkohet edhe testi RT-PCR negativ. Nga 3 janari 2022 për të hyrë në Kosovë do të vlejë vetëm certifikata e vaksinimit të plotë", ka deklaruar ai.

Ai ka treguar se procesi i vaksinimit po realizohet edhe gjatë fundjavës. "Për ta evituar mbingarkesën spitalore,

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka bërë me dije se nga sot (e hënë) do të hyjnë në fuqi masat e reja kundër përhapjes së Covid-19. Në një konferencë për media, zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije të dielën se këto masa janë përgjigje ndaj situatës së fundit të krijuar nga pandemia.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se situata epidemiologjike në Kosovë është e qetë, por mund të rrezikohet nga varianti i ri i

koronavirusit "Omicron".

Bashkë me ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi, ai ka treguar arsyet e marrjes së vendimit për ashpërsimin e masave kundër Covidit. "Festat e fundvitit shoqërohen me ardhjen e një pjese të mërgatës sonë. Ky shtim i popullsisë, bashkë me grumbullimet e shumta festive të fundvitit, rrit dukshëm mundësinë e ngjarjeve super shpërndarëse. Së dyti, situata epidemiologjike në Evropë vazhdon të jetë tejet e rëndë, sidomos në disa vende ku jetojnë një numër i madh i

## Kurti: Masat do të shtrëngohen apo lehtësohen varësisht nga situata epidemiologjike

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se masat e fundit Covid që ka marrë Qeveria e Kosovës janë përgjigje ndaj situatave të fundit të krijuara nga pandemia. Ai ka deklaruar se nëse zbutet situata me pandeminë, qeveria do ta bëjë lehtësimin e masave. "Mjeti ynë më efikas për ta mbrojtur

veten dhe të tjerët mbetet vaksinimi masiv. Nuk kam detyrë më të rëndësishme sesa ta mbroj jetën e qytetarëve me mjetet që qeveria ka në dispozicion. Për këtë arsye kemi marrë masa kufizuese. Megjithatë vazhdimisht jemi duke shqyrtuar të dhëna më të reja, mbi të cilat do t'i përditë-

sojmë masat konform situatës dhe shkallës së rrezikshmërisë. Zotimi im është se në momentin e parë që rreziqet e lartpërmendura zbuten apo dalin të jenë më pak serioze sesa po duken, qeveria do të marrë vendim të menjëherëshëm për lehtësimin e masave", ka thënë Kurti.



# Mobilizimi i bashkësive fetare për vaksinim

**PRISHTINË, 5 DHJETOR** - Disa bashkësi fetare në Kosovë i janë bashkëngjitur Ministrisë së Shëndetësisë në fushatën për vaksinim kundër koronavirusit.

Bashkësia Islame e Kosovës, përveçse ka bërë thirrje për vaksinim, ka marrë pjesë edhe në organizimin e vaksinimit në xhami përmes ekipeve mobile.

Më 19 nëntor, pas faljes së xhumasë, në disa nga xhamitë më të mëdha të Kosovës janë vaksinuar dhjetëra besimtarë myslimanë, ka konfirmuar Ministria e Shëndetësisë e Kosovës. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se parimet islame i urdhërojnë besimtarët myslimanë që të vaksinohen. "Nëse nuk vaksinohemi, edhe mëkatojmë pa dashje, pasi i bëjmë keq tjetrit", thotë Tërnavë.

Myftiu, i cili vetë është vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit,

thotë se së paku dhjetë rituale të xhumasë në 800 xhami të Kosovës i janë kushtuar çështjes së vaksinimit dhe respektimit të masave kundër koronavirusit. Sipas tij, asnjë nga imamët e xhamive që janë në kuadër të BIK-ut nuk kanë dalë kundër vaksinimit. "Individë mund të ketë, por edhe ata nuk e njohin fenë. Sikur ta njohin fenë sa duhet, nuk do të thoshin ashtu", thotë Tërnavë.

Sylejman Berila, i cili të premten e 3 dhjetorit kishte shkuar për ta falur xhumanë në njëren prej xhamive të Prishtinës, tha se është vaksinuar.

"Kam ardhur të fal xhumanë dhe i ftoj të gjithë të vaksinohen", tha ai. Rahman Xhemajli, po ashtu besimtar mysliman, tha se është vaksinuar në një qendër vaksinimi, por ekipet mobile, sipas tij, janë lehtësim për ata që nuk janë vaksinuar ende. "Duhet të merret vakcina, është diçka për shëndetin,

pasi nesër nuk dihet se çfarë bëhet. Duhet të kenë shumë kujdes, nuk është shaka, është serioze", tha ai. Përveç qendrave të vaksinimit, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës ka shpërndarë disa ekipe mobile në vend, ku qytetarët mund të vaksinohen.

Përmes aktiviteteve fetare, edhe Kisha Katolike në Kosovë ka bërë thirrje për vaksinim kundër koronavirusit.

Don Shan Zefi, kancelari ipeshkvor i Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se mbi 50 për qind e qytetarëve të besimit katolik janë vaksinuar. Ky komunitet në Kosovë numëron mbi 38 000 banorë. "Nga ditët e para të koronavirusit, Kisha Katolike i ka përfillur të gjitha masat që janë marrë nga shteti i Kosovës. Mund të pohoj edhe personalisht se në të gjitha qendrat në Kosovë jemi përpjekur t'i bëjmë të vetëdijshëm besimtarët se ata duhet të vaksinohen, sepse është në të mirë të kishës, familjes dhe

individit", thotë ai.

Pastori Artur Krasniqi, i cili përfaqëson komunitetin protestant të Kosovës, thotë se në kishën e tyre nuk flasin për çështjen e vaksinimit. "Çështja e vaksinimit është çështje personale dhe nuk ndërhyjmë", thotë ai. Megjithatë, sipas tij, shumica e njerëzve që frekuentojnë kishën protestante janë të vaksinuar. "Nga 150 persona që vijnë në kishë, tre veta që e di unë, nuk janë të vaksinuar për shkak të bindjes së tyre, mendojnë se [vaksina] është e dëmshme", thotë Krasniqi, i cili vetë është i vaksinuar.

Në Ministrinë e Shëndetësisë në Kosovë kanë bërë me dije se janë duke punuar me të gjitha komunitetet fetare për ta rritur shkallën e vaksinimit kundër koronavirusit, që aktualisht është mbi 42 për qind.

Sipas Ligjit për Lirinë Fetare, në Kosovë njihen pesë bashkësi fetare: Bashkësia Islame e Kosovës, Kisha

Ortodokse Serbe, Kisha Katolike, Bashkësia e Besimit Hebre dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës.

Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, nga rreth 1.8 milion banorë sa i ka Kosova, mbi 1.6 milion i takojnë besimit islam.

Sa iu përket vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, në Mal të Zi vetëm Bashkësia Islame ka bërë thirrje për vaksinim kundër koronavirusit. Kisha ortodokse nuk ka bërë thirrje për vaksinim, ndërsa ajo katolike e ka lënë vendimin në duart e besimtarëve.

Bashkësitë fetare në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Serbi nuk kanë marrë pjesë në fushatën për vaksinim.

Bashkësia Islame në Bosnje e Hercegovinë ka thënë se nuk do të marrë qëndrim lidhur me këtë çështje, duke ua lënë qytetarëve të vendosin vetë, në konsultim me mjekët.



mbylljen e shkollave dhe ekonomisë, udhëtarëve që shërbehen me transportin publik dhe privat do t'u kërkohen dëshmi si vaksinimi i plotë apo pjesshëm dhe bashkë me të, shërimi apo rezultati negativ i virusit", ka thënë Latifi. Sipas masave të reja, kërkohet nga të gjithë personat që do të hyjnë në

Kosovë pas datës 3 janar 2022, të kenë dëshmi të vaksinimit të plotë, ose një dozë të vaksinës bashkë me test negativ PCR, ose një dozë e vaksinës me dëshminë e kalimit të sëmundjes.

Shtetasve të Kosovës dhe atyre me qëndrim të përkohshëm, me masat e reja, u jepet "mundësia të vaksinohen nga

ekipet mobile të vendosura në pikat kufitare" tokësore, por edhe në aeroportin "Adem Jashari".

Nga paraqitja e dëshmimeve për vaksinim apo testeve për Covid-19, sipas masave të reja, do të përjashtohen personat që kalojnë transit nëpër Kosovë, personat nën 12 vjeç si dhe ata që kanë dëshmi mjekësore se

nuk mund të vaksinohen.

Dëshmia e vaksinimit të plotë do të kërkohet edhe nga personat që përdorin transportin publik. Gjithashtu, sipas këtyre masave, mbajtja e maskës vazhdon të jetë obliguese. Ndërsa kufizimi i lëvizjes do të vazhdojë të jetë në fuqi nga mesnata deri në orën 05:00. Masat e reja nuk

parashohin ndonjë ndryshim për gastronomi.

Puna në këtë sektor lejohet deri në orën 23:00, ndërkaq muzika ndalohet pas orës 21:30. Klubet e natës dhe organizimi i ahengeve vazhdon të jetë i ndaluar, thuhet në vendimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me masat për pandeminë.




## Policia gjen drogë të fshehur te motori i një veture, arrestohet një person

Prishtinë, 5 dhjetor - Policia kufitare ka njoftuar se më 4 dhjetor rreth orës 21:05, në pikëkalimin kufitar në Vermicë, nga Shqipëria për në Kosovë, ka hyrë një automjet me targa të Kosovës të cilin e

drejtonte shtetasi kosovar me initiale (Y. S.), viti i lindjes 1994, në Prishtinë. Pas dyshimeve të bazuara të policisë, automjeti është ndalur për kontroll në vijën e dytë. Gjatë kontrollit nga Policia dhe Dogana e Kosovës, në

pjesën e motorit të automjetit është zbuluar një sasi rreth një kilogram (1 kg) substancë e dyshuar si marijuanë e cila ishte e mbështjellë në një qese najloni. Lidhur me rastin është njoftuar edhe Prokuroria

Themelore në Prizren dhe me vendim të prokurorit kujdestar i dyshuari është dërguar në mbajtje për 48 orë. Rasti për hetime të mëtutjeshme adresohet te Njësia Rajonale e Hetimeve të Antidrogës në Prizren.



## Kurti: Në javën e dytë të dhjetorit mund të ndodhë takimi me Vuçiqin

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se është diskutuar mundësia që në javën e dytë të dhjetorit të ketë një takim në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Të dielën, në një konferencë për media, Kurti tha se nuk ka informacione se ka kushtëzime nga dikush sa i përket mbajtjes së një takimi të tillë. "Vetëm vlerësimi se duhet të mbahet një takim i tillë ose jo i përket ndërmjetësuesit, lehtësuesit, siç e quajmë ata veten, përkatësisht zëvendës-presidentit të Komisionit Evropian, përfaqësuesit të lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell dhe emisarit të tij (Miroslav) Lajçak. Janë ata të cilët e vlerësojnë nëse do të na i dërgojnë ftesat ose jo, e jo çfarëdo kushtëzimi i palës tjetër", ka thënë Kurti.

Deri më tani, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, Kurti është takuar dy herë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Takimi i tyre i fundit u zhvillua më 19 korrik, por palët nuk arritën ndonjë rezultat konkret. Më herët Bashkimi Evropian kishte thënë se synon të organizojë një takim në mes të Kurtit dhe Vuçiqit para fundit të vitit.

Kurti, po ashtu, ka thënë se e përshëndet emërimin e ish-shefit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Sir Stuart Peach, i dërguar i posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor. Kurti ka theksuar se vëmendja e shtuar e Mbretërisë së Bashkuar është e mirëseardhur për shkak të rritjes së ndikimit të Federatës Ruse në Ballkanin Perëndimor. "Ne kemi nevojë për sa më shumë vëmendje të aleatëve dhe partnerëve perëndimorë në rajonin tonë, meqë qartazi vëmendja, investimet dhe



ndikimi të fqinji ynë verior i fuqive dhe superfuqive nga lindja dhe verilindja, është rritur shumë kohën e fundit. Ka një lloj inkurajimi në këtë dekadë të Federatës Ruse pas zhvillimeve

negative në Abkhazi dhe Osetinë Jugore", ka deklaruar Kurti. Në rolin e të dërguarit të posaçëm, Peach do të punojë me liderë të Ballkanit

Perëndimor, me zyrtarë të tjerë rreth rajonit dhe aleatë të Mbretërisë së Bashkuar në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë për ta mbështetur dhe forcuar stabilitetin rajonal.

## Policia kryen aksion kundër trafikimit të qenieve njerëzore



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka mbyllur tetë lokale gjatë kontrolleve dhe inspektimeve nën dyshimet për trafikim të qenieve njerëzore. Policia ka njoftuar se kontrollet janë kryer në 43 lokale në rajone të ndryshme të Kosovës. Sipas

njoftimit, në këto lokale, autoritetet kanë hasur 286 punëtorë të legjitimuar, nga ta 133 shtetas dhe shtetase të Shqipërisë e të Kosovës, 19 të Serbisë dhe dy të Bullgarisë. "Për të gjithë shtetasit e huaj, në mungesë të paraqitjes së lejes së punës, qëndrimit, do

të vazhdohet verifikimi i tyre dhe do të referohen në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj", thuhet në njoftimin e policisë. Gjatë këtij aksioni, sipas Policisë së Kosovës, është konfiskuar edhe një armë zjarri.

## Nis punimet Forumi i Tetë për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Islame

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe ka nisur punimet Forumi i Tetë për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Islame. Në këtë forum po merr pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të tij, mr. Besim

ef. Mehmeti. Ky forum ka mbledhur pranë vetes myfti, ministra të punëve fetare, përfaqësues nga komuniteti mysliman, si dhe delegatë nga Kombet e Bashkuara dhe organizatat e të drejtave të njeriut nga mbarë bota. Për shkak të pandemisë, ky forum

kësaj radhe po mbahet në rrethana të jashtëzakonshme, andaj si rrjedhojë edhe numri i pjesëmarrësve është i kufizuar. Ky forum është i teti me radhë dhe do të zgjasë dy ditë. Temë kryesore e këtij forumi është "Qytetaria - shtetësia gjithëpërfshirëse".





# Kosova, e vetmja në rajon pa rezervë të arit



**PRISHTINË, 5 DHJETOR** - Kosova është shteti i vetëm në rajon i cili nuk ka rezervë të arit. Banka Qendrore e Kosovës, në një përgjigje me shkrim për "Radion Evropa e Lirë", ka konfirmuar se "për momentin nuk mban në portofolin e saj rezerva ndërkombëtare në ari dhe metale të tjera të çmuara". Ndërkaq në pasqyrën e mjeteve financiare të publikuara nga kjo bankë, figurojnë rreth 1 miliard e 847 mijë euro si rezerva të kapitalit.

Ari, si pasuri, ka një likuiditet dhe stabilitet më të madh të çmimit dhe shtetet që nuk dëshirojnë të pranojnë ndonjë risk të lartë, orientohen që si aset të tyre financiar ta ruajnë në rezervat e tyre arin.

"Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Financave, me pyetjen se pse Kosova nuk ka rezerva të arit dhe a ka ndonjë plan që t'i krijojë rezervat e tilla. Por, deri më tash kjo ministri nuk ka kthyer përgjigje.

Haki Shatri, ish-ministër i Financave në Qeverinë e Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ekzistojnë mjaft arsye pse Kosova nuk ka arritur të krijojë rezerva të arit. Sipas tij, Kosova ka dalë nga lufta në vitin 1999 pa trashëguar rezerva të tilla nga ish-Jugosllavia. Sipas tij, Kosova në pesë vjetët e para pas luftës kishte investuar në krijimin e infrastrukturës institucionale dhe krijimin e parakushteve për ta formuar shtetin, me një buxhet shumë formal prej rreth 300 milionë eurove. Pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008, ishin nevojitur investimet për ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e ligjeve dhe ndërtimin e institucioneve që merren me

inkasim të tatimeve dhe doganat. "Arsyeja se pse s'kemi (rezerva të arit), fillimisht, është kapaciteti i dobët dhe mundësia e vogël për të pasur më shumë (kapital buxhetor). Nëse do të kishim pasur rezerva më shumë, atëherë në vend se t'i ruanim ato në valutë, shteti do t'i shndërronte ato në rezerva të arit, në qoftë se do të vlerësohej se ecuria e çmimit të arit, kur blihet, është e favorshme. Por, varet edhe nga lëvizjet e çmimit në treg", thotë Shatri.

Përveç mungesës së rezervave të arit, Kosova nuk ka as valutën kombëtare të saj dhe në përdorim ka euron. Në mungesë të valutës kombëtare edhe Mali i Zi e përdor euron, ndërkaq vendet e tjera të dala nga ish-Jugosllavia i kanë valutat e tyre kombëtare.

Mejdi Bektashi, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë", thotë që mospasja e valutës kombëtare arsyetohet me mospasjen e rezervave të arit. Sipas tij, Republika e Serbisë është trashëguese e ish-sistemit të Jugosllavisë. Siç thotë Bektashi, shtetet që kanë dalë nga ish-Jugosllavia kanë trashëguar pjesë të pasurisë mbi 200 tonelata ari që ishin rezerva të ish-shtetit të përbashkët. Por, Kosova ende nuk njihet nga Serbia dhe, për pasojë, siç thotë ai, ndërmjet këtyre dy vendeve nuk është kryer suksesioni financiar dhe ekonomik. Rrjedhimisht, Kosova nuk ka trashëguar pjesë nga pasuria e arit që ka pasur ish-Jugosllavia dhe trashëgimtarja e saj, Serbia. "Derisa nuk përfundojnë problemet politike ne nuk mund të fillojmë të kyçemi në suksesion ekonomik dhe financiar me Serbinë. Arsyeja tjetër që ne jemi i vetmi shtet që

nuk kemi rezerva të arit ka të bëjë edhe me kufizimet e caktuara që i ka pasur Banka Qendrore në periudhën e caktuar. Ndonëse, sipas një formule, të gjitha shtetet e zhvilluara i ruajnë rezervat në një të tretën për ta shpërndarë riskun në dollarë, euro dhe ari. Ne jemi të vetmit që kemi vetëm euro", shprehet Bektashi.

## Pafuqia për t'i krijuar rezervat e arit

Ish-ministri Shatri shpreh mendimin se duke marrë parasysh kërkesat e mëdha që ka pasur vendi gjatë ndërtimit të shtetësisë, përballë buxhetit, sipas tij, jo të madh, për pamundësinë e krijimit të rezervave të arit nuk duhet të fajësohet askush. "Nuk mund t'ia lë fajin asnjëherë prej qeverive dhe as kësaj aktuale sepse nuk është varur prej tyre. Thjesht, nuk ka pasur mundësi dhe ky është potenciali ynë", vlerëson Shatri. Ai shton se mbetet vetëm për të shpresuar që Kosova nuk do të gjendet përballë ndonjë krize, ku rezervat e arit do të ishin të domosdoshme.

Profesor Bektashi thekson se shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor në vitet e fundit të krizës financiare i kanë shtuar dukshëm rezervat e arit. Por, ai shpreh mendimin se edhe në rast se eventualisht Kosova do të niste të siguronte rezervat e arit, aktualisht nuk është koha për një gjë të tillë. "Tani çmimi i arit ka arritur për një ons (31.103 gramë) mbi 1 700 dollarë, prandaj është rrezik që me këtë çmim, i cili ndoshta në të ardhmen, nëse tejkalohet kriza financiare dhe kriza energjetike, e cila ka kapluar jo vetëm rajonin, por edhe botën, mund të ulet", thekson Bektashi.

Aktualisht rezervat e arit të

Serbisë janë 37.2 tonelata. Maqedonia e Veriut ka 6.9 tonelata rezerva të arit, Bosnjë e Hercegovina ka 2.9 tonelata, Shqipëria ka 2.8 tonelata. Ndërkaq Mali i Zi ka 1.9 tonelata rezerva të arit, por ato janë të deponuara për kredi.

Së fundmi, Serbia i ka kthyer në vend të gjitha rezervat e arit të cilat i ruante jashtë vendit. Aktualisht, 37.2 tonelata të arit, sa ka rezerva Serbia, kanë vlerën 1.9 miliard euro. Sipas Bankës Kombëtare të Serbisë, arsyeja për kthimin e shufrave të arit nga kasafortat në Zvicër dhe Angli, është se "në një mjedis të pasigurisë globale të shtuar, ajo dëshironte të rriste më tej sigurinë dhe mundësinë e qasjes të arit të saj". Megjithatë, kjo bankë nuk ka sqaruar se për çfarë rreziku konkret bëhet fjalë. Njohësi i çështjeve të ekonomisë në Serbi, Sasha Gjigoviq, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Serbia ka rezerva të mjaftueshme të valutave, pa e llogaritur arin.

"Në rast të çrregullimeve vërtet

të mëdha, çmimi i arit rritet në raport me valutat dhe në atë rast jeni më të sigurt, sepse mund të shisni sasi të caktuara. Ari shërben për momente të vështira kur situatat ekonomike globale janë të pafavorshme ose në rast të presioneve dhe sanksioneve të mundshme politike, në mënyrë që të mos i ngrini rezervat tuaja diku jashtë vendit", thotë ai.

Ari ruhet tradicionalisht në kasafortat e bankave të huaja, ndërkaq në kohë paqëndrueshmërie, vendet e tërheqin atë për t'u siguruar që mund ta përdorin në rast krize. Tani, sipas ekonomistit Sasha Gjigoviq, ajo mund të lidhet me pandeminë e virusit korona. "Shqetësimi kryesor global aktualisht është pandemia, sa do të zgjasë ajo dhe a mund të shkaktojë format e reja (të pandemisë) luhatje të reja në treg, gjë që mund të çojnë përsëri në një rënie të rrjedhave ekonomike. Në ato raste, çmimi i arit do të rritej përsëri", thotë Gjigoviq.

## Kush i ka rezervat më të mëdha të arit?

Bankat qendrore të botës aktualisht mbajnë më shumë se 35 000 tonelata ar. Sipas të dhënave të Këshillit Botëror të Arit (World Gold Council), i cili mban shënime sipas vendeve, Shtetet e Bashkuara kanë rezervat më të mëdha të arit 8,133 tonë, që është pothuajse 78 për qind e totalit të rezervave valutore të vendit.

Pas saj vjen Gjermania me 3,359 tonë dhe Italia dhe Franca me më shumë se 2,000 tonë ar. Sasi të konsiderueshme ari në dekadën e fundit kanë blerë Rusia dhe Kina, të cilat zënë vendin e pestë dhe të gjashtë në listën botërore.

Banka Qendrore e Rusisë aktualisht zotëron 2,292 tonë ar, gjë që e rriti sasinë e rezervave në më shumë se 20 për qind. Rusia rriti më tej blerjet e saj në vitin 2018, pasi investimet në bono amerikane u shkurtuan pasi Uashingtoni vendosi sanksione ndaj atij vendi për shkak të aneksimit të gadishullit ukrainas të Krimesë, shkruan "Reuters".



# 'E paemra' me emër të madh



Lajmi për vrasjen e Mervete Maksutajt në spitalin e Pejës do të ketë jehonë të dhembshme në Kosovë atë 4 dhjetor të vitit 1998. Meqë vrasja ndodhi në një zonë që s'e kishte përfshirë lufta, mendohej se ajo ishte edhe një nga viktimat e shumta të pafajshme në Kosovë. Por, Mervetja e dinte saktësisht se ç'kërkonte atë ditë në spitalin e Pejës ...

**Nga: Dush Gashi (shkrim i publikuar në Javoren Politike Shqiptare "Zëri", në dhjetor të vitit 1999)**

Më 4 dhjetor të vitit 1998, ndonëse këtë vit Kosova kishte hyrë "mirë" në luftë dhe opinionin ishte "mësuar" me lajmet e shpeshta për vrasjet, edhe asosh më barbare, një lajm i dhembshëm megjithatë do ta trondisë Kosovën: një vajzë do të vritet nga policia serbe në spitalin e Pejës. Meqë kjo anë ende nuk ishte përfshirë nga lufta, mendohej se është ajo edhe një viktimë e pafajshme, të cilën propaganda serbe pastaj do t'ia mveshë epitetet e njohura për shqiptarët. Por, Mervete Maksutaj, ndonëse jo edhe shokët e saj të luftës, e dinte saktësisht se ç'kërkonte atë ditë në spitalin e Pejës. Këtë do ta marrë vesh shpejt edhe opinionin kosovar, ndonëse vetë

ngjarja, siç ndodh shpesh me ngjarje të tilla, e përshkonte një tis mjegulle, si në baladat e moçme shqiptare...

Por, edhe jeta e Mervetes, edhe akti i saj heroik e vetëflijues ngjajnë me baladat shqiptare... Pjesëmarrëse e luftës për çlirim që sa muaj më parë e atë ditë në një aksion për ta shpëtuar një shok lufte, ajo kishte edhe një motiv personal për luftë kundër serbëve: të merrte hak për të vëllanë e vranë.

## DRAMAT KISHIN DALË NGA SKENA

E lindur 20 vjet më parë në fshatin Orroberdë të komunës së Istogut, Mervetja do të kalojë fëmijëri e rini të vështirë, me dhembje e trauma. Në moshën nëntëvjeçare mbetet pa të ëmën, kështu që për të e fëmijët tjerë do të përkujdeset Hidajetja, motra e madhe. Vetëm katër vjet më vonë, në vend se t'i gëzohet kthimit të

vëllait, Enverit, nga ushtria, ajo do të pësojë edhe një goditje tepër të rëndë: i vëllai do të kthehet në arkivol. Ishte kjo kohë kur vrasjet e të rinjve shqiptarë në ushtrinë jugosllave ishin të shpeshta, kurse shpjegimet për to tepër cinike. Kjo tragjedi do të lërë vragë të pashlyera në shpirtin e vajzës 14-vjeçare. Vajza e bëshme, e qetë dhe e dashur, çfarë e përshkruan të ketë qenë edhe sot motra e saj e madhe, mbyllet në vetvete dhe, që në atë moshë, mendon për hakmarrje.

"Nuk qante pranë arkivolit të të vëllait, e puthte dhe i thoshte: 'Unë jam ajo që do ta marr hakun ty dhe djemve të tjerë shqiptarë që serbët i vrasin vetëm pse janë shqiptarë'", do të dëshmojë Hida, infermiere në qendrën për rehabilitim "Ilixha" në Bajë.

Atlete e shkëlqyer, e cila për disa vjet radhazi do të mbajë vendin e parë në Kosovë në vrapim, Mervetes nuk i

mungonte as talenti për aktrim dhe luajti në disa shfaqje me Nazmi Muzliajn, edhe ai i rënë dëshmor.

Dramat e tragjeditë e mëdha në Kosovë edhe njëherë kishin dalë jashtë teatrit.

Për luftën ajo fliste edhe më herët, por një motër e saj, e martuar në Ratish të Deçanit, e cila kishte ikur nga zona e zjarrit, bënte që lufta të ndjehej më shumë edhe në Orroberdë, deri atëherë relativisht të qetë. "O njerëz, kjo luftë nuk po bëhet në tjetër shtet. Duhet të shkojmë edhe ne", thoshte shpesh Mervetja, përkujton motra Hida.

Kurrë nuk ishte paraqitur në polici për të marrë letërnjoftim. "S'e dua letërnjoftimin që ma japin serbët", thoshte.

Pastaj, në përsiatjet e saj për pjesëmarrje në luftë, mungesa e letërnjoftimit do t'i shfaqet si mundësi e trishtë që të pësojë si "një kufomë e pidentifikuar".

"Do të vdes e paemër", thoshte Mervetja.

Niseshin grupe edhe nga kjo anë, po asaj s'i tregonin. Po atë s'mund ta ndalte kush.

"Një ditë bëri gati një valixhe dhe, ndonëse nuk e tha, ne e dinim fare mirë se ku po shkonte. Po s'provuam ta ndalnim. E dinim se është punë

e kotë", thotë Hida.

Bashkëluftëtarja e saj, Hyrie Veliu-Jeta, e cila edhe jep të dhëna të jetëshkrimit luftarak të Mervetes, do të thotë se ajo ka udhëtuar këmbë nga Istogu për t'iu bashkangjitur radhëve të UÇK-së në Jabllanicë. Në radhët e UÇK-së u inkuadrua më 11 korrik 1998, ku filloi përgatitjet e para për luftë në kuadër të njësitit "Vashat me kordele të kuqe", i cili më vonë do të hyjë në përbërje të Brigadës 132 "Myrtë Zeneli". Ajo dëshironte që pas përgatitjeve të kthehej në vendlindje, mirëpo rrethanat e luftës dhe ofensivat e njëpasnjëshme të gushtit dhe të shtatorit ia pamundësuan kthimin për një kohë.

## NJË HERË VDISET...

"Katër muaj s'kemi ditur gjë për të", thotë Hida.

Po sipas Hyrie Veliut-Jetës, Mervetja mori pjesë aktive në luftën e Jabllanicës gjatë ofensivës së parë serbe, e cila u ndërmor më 2 gusht 1998 si dhe në atë të 8 shtatorit. Ajo nuk pranoi të heqë pushkën nga krahu, por krahu për krahu me shokë e shoqe çau rrethimin e hekurt në Broliq, për të vazhduar më pas veprimtarinë e vet në



Jabllanicë, ku me javë të tëra me shokët e saj qëndroi në istikame ballë për ballë me armiq të serbë, të cilët ato ditë kishin zënë pozicionet rreth e qark Dushkajës. Mori pjesë në disa aksione, në të cilat armiku pësoi humbje.

Më 2 nëntor 1998, vendosi të kthehet e të veprojë në anën e Istogut, në Brigadën 133 "Ardian Krasniqi", në formim e sipër.

Prania e saj në këtë brigadë ua ngriti moralin shumë të rinjve istogas, ndaj shumë prej tyre iu bashkuan radhëve të UÇK-së.

E vendosur për luftë, Mervetja, mbase duke e ditur se do shkojë deri në fund, apo sikur ta kishte parandjerë vdekjen, ajo edhe sikur do ta paralajmërojë atë me një letër, të cilën pas ngjarjeve në Broliq do t'ia dërgojë së motrës: "Parandjej se së shpejti do të vdes, por frikësohem shumë se do të vdes pa i realizuar synimet e mia dhe të shokëve të mi. Gjithashtu, parandjej se do të vdes me mallin për vëllezërit dhe motrat e mia. Dëshiroj një vdekje të lehtë, por të madhe, sepse një herë vdiset; po parandjej se vdekja ime do të jetë e tmerrshme, ashtu siç ishte edhe vetë jeta ime", shkruante ajo.

Naim Xhuraj, tash shef i Shtabit të Brigadës 333 të Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Istog, në periudhën e ilegalitetit, ndonëse atëherë nuk ishin formalizuar raportet mes ushtarakëve të ardhshëm, ishte epror i Mervetes dhe e ka njohur atë për së afërmi.

"Ishte pothuaj femra e vetme nga kjo anë, e cila në vitin 1998, bashkë me ca vullnetarë nga trekëndëshi Pejë-Klinë-Istog iu bashkangjitur radhëve të UÇK-së në zonën e Dukagjinit, në të cilën kishte filluar lufta", thotë ai.

Bashkë me Muhamet Demajn, në atë kohë komandant i

Njësisë Speciale të Brigadës 333, Besnik Shalën, Agim Elshanin e Azem Veselin, Naimi, me direktivë të Ramushit (Haradinajt), nga pjesa ku kishte luftë kishte kaluar këtej Bisticës dhe kishte filluar themelimin e celulave të para, apo, siç shprehet, "mbledhjes së fijeve" të njerëzve që janë të gatshëm t'i bashkëngjiten luftës.

Në atë kohë Mervetja ka shërbyer në Jabllanicë të Gjakovës dhe ka dëgjuar se këtej po lëvizin gjërat, prandaj ka kërkuar transfer, i cili i është lejuar prej komandant Ramushit. Atë kohë këtej s'ka pasur aktivitete legale.

"Kam njohur edhe femra të tjera në luftë, por Mervetja më ka lënë përshtypjen e një femre të rrallë. S'liste po të mos e pyesje gjë e edhe kur e pyesje përgjigjej shkurt".

E matur për gjithçka, shokët e saj mbase do ta mbajnë mend vetëm njëherë të ketë shpërthyer në të qeshur të papërmbytur, kur një shok i saj tullac e kishte vënë në kokë një paruke femrash", kujton Naimi.

### T'IA KËRSASIM DIKUND!

"Por, për dallim prej shokëve, qetësinë e përballonte më së vështiri. I dëshironte aksionet dhe shpesh më thoshte: Naim, s'jemi duke bërë kurrëgjë. T'ia kërcasim dikund! E ardhur nga një zonë, ku përplasjet me policinë ishin thuaja të përditshme, puna që ne e bënim i dukej se 'nuk po shihet'. Po koha ishte e tillë që duhej punuar tepër shumë e të shihej tepër pak, prandaj gjithmonë kërkonte aksione. Fatkeqësisht, s'na ka rënë që të jemi bashkë në ndonjë aksion", thotë Naimi.

Koordinatorë për themelimin e një brigade këtej, Naimi me shokët e Merveten, gjatë aktivitetit ilegal më së shumti do të qëndrojnë në fshatrat

Ruhot e Radavc, pastaj në Ozdrim, kurse, në një periudhë prej dy javësh, me sa i kujtohet, "për disa detyra të caktuara", janë ndarë në tri grupe, pas kryerjes së të cilave prapë bashkohen në Ruhot. "Jemi ndarë me short dhe mua më ra të jem me Merveten", evokon Naimi.

Ato ditë plagoset një shok, Naim Lushi nga Qyshku i Pejës. Shokët e tij kishin bërë përpjekje që Naimin ta operojnë jashtë spitalit, sepse e dinin se spitali është nën kontroll të policisë serbe. Kishin kontaktuar me ca mjekë të cilët kishin vlerësuar se plaga e Naimit është e rëndë dhe se ai vetëm në spital do të mund të shërohej. Ata kishin premtuar se do të përpiqen të gjejnë një shkak tjetër të plagëve të tij, e jo plumbat nga lufta. Por, kjo s'kishte mundur të fshihej më, pas radiografisë. Megjithatë, Naimi kishte mbetur për shërim në spital, i kishte kaluar me sukses operacionet, por tash e "shoqëronte" edhe roja policore serbe.

Shokët e mendonin një aksion për ta nxjerrë nga spitali dhe, përkundër rojës, ia kishin dalë ta dërgonin brenda një femër, në mënyrë që të koordinoheshin veprimet. Mirëpo, për aksionin për nxjerrjen e Naimit nuk kishin biseduar fare ditën kur Mervetja do ta fillojë atë. E dinin se nevojitet një aksion shumë i koordinuar dhe se duhej të vepruar në bashkëpunim me personelin e spitalit. Pa dijen e shokëve, Mervetja, bashkë me Besnik Shalën ishin marrë vesh që ata ta ndërmarrin këtë aksion.

"Ishim në Ruhot dhe Mervetja dukej ca e shqetësuar atë ditë, hynte dilte, prandaj e pyeta se ç'e mundonte. Më tha se e ka ndërmend të shkonte deri në Pejë me Besnikun dhe se po e mundonte mungesa e një revoleje. Ia dhashë një timen

7.65 milimetërshe, kurse në xhepa kishte pasur granata dore. Nuk e dinim destinimin e tyre", thotë Naimi.

Do të jetë ky aksioni i fundit i Mervetes.

I rrëfyer nga Besnik Shala, bashkëpjesëmarrës i drejtpërdrejtë, aksioni nuk kishte filluar mbarë që në start. Kanë shkuar në repartin poshtë, ku janë ambulancat specialiste dhe policia i ka vërejtur si të dyshimtë. Që t'i shmangen dyshimit janë nisur në drejtim të Spitalit të Përgjithshëm, lart. Atë ditë spitali thuaja se ishte i bllokuar nga forcat policore. Rojat ua kërkojnë letërnjoftimet dhe urdhërojnë "nxirrni gjithçka keni në xhepa."

Mervetja e Gazi dihej se ç'mbanin në xhepa.

### DITARI ENIGMATIK

Gazi (Besniku) e nxjerr granatën e dorës, ia heq siguresën, por siguresa nuk i del e tëra, njëri tel i këputet. Edhe Mervetja e nxjerr revolen. Një polic, që rrinte te dera, fillon të shtjerë. Përplasen fizikisht. Besniku e kap për pushke, ia merr armën nga dora dhe gjatë tërë kohës sa vazhdonte gara për kallashnikovin kishte të shtëna të pakontrolluara. Gazi e Mervetja tashmë ishin identifikuar fare se kush janë. Fillojnë tërheqjen.

Në vrap e sipër, Gazi, derisa përpiquej ta mbronte me të shtëna nga automatiku, e këshillon Merveten: Ec në drejtim të dispanserisë, ik me cik-cake. Ajo vrapon në drejtim të parkut të spitalit, por drejt. Nga prapa e qëllon një plumb në kokë dhe përplasat në tokë. Goditja ishte vdekjeprurëse.

Gazi, me shumë mundime ia ka dalë të tërhiqet dhe diku pas mesnate është kthyer tek shokët, në Ruhot.

"Kishim dëgjuar për aksionin,

por kishim menduar se janë vrapë të dytë", thotë Naim Xhuraj.

"Kemi qenë duke punuar në planin për nxjerrjen e Naimit. Por, Mervetja sigurisht se e kishte biseduar me Gazin, duke menduar se do t'ia arrijnë ta nxjerrin pa ndihmën e ndokujt tjetër. Dinim se duhet një plan i përsosur dhe po shihet se janë ngutur. Por, Mervetja i donte aksionet", thotë z. Xhuraj.

"Një vajzë e pjekur, pas një fëmijërie e jete të mundimshme, e rritur pa nënë e me sfida të ndryshme, pastaj t'i bashkëngjitej luftës, që për femra njëmend ishte e vështirë, unë nuk e di nga e gjente atë forcë", do të shprehet me pikëllim Naimi.

"Akti i Mervetes, të nisesh me një revole duke e pasur të qartë se me çka do të përballohesh, janë njerëz të rrallë, të cilët hyjnë duke e ditur se gjasat për kthim janë zero ... nuk gjej shprehje ta përshkruaj këtë trimëri", thotë ai.

"Për këtë pjesë ende ishte e pabesueshme se ka ushtri, kështu që për herë të parë edhe ne jemi paraqitur publikisht në varrimin e saj, Besniku, Muhamet Demaj, Azem Veseli, Luljeta Berisha (Arta), edhe unë."

Mervetja kishte mbajtur ditar para lufte dhe këtë shprehi të saj e kishte vazhduar edhe gjatë luftës. Por, enigmatike, siç ishte për së gjalli, ajo do të lërë enigma edhe pas vdekjes: ditari i saj i luftës është i shifruar, kurse kodin e deshifruar, me gjasë, ajo e ka marrë me vete në varr.

E, me gjasë, droja se do të mbesë e paemër kishte qenë e vërtetë. Pas vrasjes, në qafë ia kanë gjetur një medaljon me emrin e mbiemrin e shkruar dhe akronimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, nuk kishte dro se do të vdiste e paemër. Ajo kishte bërë emër të madh. /Telegrafi/





**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com

**SPORT**

**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

## Drita fiton derbin në 'Fadil Vokrri', Ballkani ruan pozitën e parë

**PRISHTINË, 5 DHJETOR** - Është përmbyllur java e 17-të në BKT Superligë me tri ndeshjet e zhvilluara të dielën. "Dua t'i përgëzoj djemtë për grintën dhe për luftën që zhvilluan në fushë. U vendosëm mirë taktikisht dhe nuk lejuam kundërshtarit të na rrezikojë. Futbollistët janë më meritoret për këtë fitore. Kemi krijuar shumë raste si në pjesën e parë, po ashtu edhe në të dytën dhe me meritë e morëm fitoren në kryeqytet. Ishim shumë të disiplinuar duke ditur se Prishtina ka cilësi. Përveç atij goli, kemi mundur të shënojmë edhe më shumë, por rëndësi kanë tri pikët", ka thënë Ardian Nuhiu, trajner i Dritës.

Derbi i kësaj jave ndërmjet Prishtinës dhe Dritës, që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri", është mbyllur me fitoren e skuadrës mysafire me rezultat 1-0. Përcaktues ka qenë goli i shënuar nga Marko Simonovski, me gjuajtje

me kokë pas harkimit të Arbnor Mujës, në minutën e 36 të takimit. Kjo fitore e mban Dritën në hap me dy skuadrat e tjera të kreut të renditjes, Ballkanin dhe Gjilanin, pasi ka 31 pikë në renditje, dy më pak se lideri, përkatësisht një më pak se rivali i qytetit, derisa Prishtina mbetet në pozitën e pestë me 24 pikë. "Drita është një skuadër e fortë dhe luajti e disiplinuar duke tentuar që nëpërmjet kundërsulmeve të vijë deri te goli dhe që në fund ia doli të bëjë gol. Ne nuk kemi ditur t'i shfrytëzojmë rastet tona dhe jemi dënua me një gol. Ne duhet të jemi më konkret në rastet që i krijojmë për gol", ka thënë Abdullah Ibrahimoviç, trajner i Prishtinës.

Në dy ndeshjet e tjera nuk pati fitues, por as gola. Llapi nuk arriti të shkëpusë më shumë se një pikë në duel me Dukagjinin në Klinë, ndërsa skuadra e fundit në renditje, Feronikeli, arkëtoi një pikë në Lipjan në përballje me skuadrën e



parafundit, Ulpienën. Ndërsa të shtunën janë zhvilluar dy ndeshjet e para në kuadër të javës së 17. Ballkani ka shënuar fitore të vështirë si mysafir në duel me Drenicën, duke e ruajtur pozitën e parë në renditje. Ndeshja në stadiumin "Bajram Aliu" u mbyll me rezultat 0-1. Golin e fitores për portokallezinjtë nga Suhareka e

shënoi Bajram Jashanica në minutën e 50. Ndërkohë, fitore tejet të rëndësishme me përmbysje të rezultatit ka shënuar Gjilani në shtëpi, duke e mundur Malishevën me shifrat 3-1. Mysafirët kaluan të parët në epërsi me golin e Hasan Hysenit në minutën e 14, mirëpo gjërat ndryshuan në minutat e fundit të pjesës së parë, kur

fillimisht Malisheva mbeti me 10 lojtarë pas përjashtimit të Muhamet Hysenit, derisa në minutat shtesë Gerhard Progni barazoi rezultatin në 1-1. Në pjesën e dytë gjilanasit arritën ta përmbytin rezultatin me golat e Keita Razak (73') dhe Albert Dabiqajt (81').

### BKT SUPERLIGA

Prishtina - Drita	0-1
Ulpiana - Feronikeli	0-0
Dukagjini - Llapi	0-0
Gjilani - Malisheva	3-1
Drenica - Ballkani	0-1

### Tabela

1. Ballkani	33 pikë
2. Gjilani	32
3. Drita	31
4. Llapi	26
5. Prishtina	24
6. Drenica	20
7. Malisheva	18
8. Ulpiana	18
9. Dukagjini	17
10. Feronikeli	11

## Federata Evropiane e Xhudos i shpërblen dy kampionet olimpike të Kosovës

**PRISHTINË, 5 DHJETOR** - Federata Evropiane e Xhudos (EJU) i ka shpërblyer me dekoratë kampionet olimpike të Kosovës, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, për arritjet e tyre gjatë vitit 2021. Në një Gala Mbrëmje të shtunën në Stamboll të Turqisë me dekoratë u shpërblje edhe Federata e Xhudos e Kosovës. Krasniqi dhe Gjakova iu bashkuan Majlinda Kelmendit si kampione olimpike, pasi fituan medalje të arta në Lojërat Olimpike "Tokio 2020" gjatë kësaj vere në Japoni. Kosova i fitoi dy medalje të arta në Tokio,



duke e çuar në tri numrin e përgjithshëm të medaljeve në historinë e vet në Lojëra Olimpike, pas medaljes së parë olimpike të

artë, po ashtu, të Majlinda Kelmendit në debutimin e Kosovës në Olimpiadë në "Rio 2016". Distria Krasniqi e fitoi medaljen e artë në kategorinë 48 kilogramë, e cila ishte e para për Kosovën në Tokio dhe e para për të në karrierë. Nora Gjakova e përsëriti suksesin duke e fituar medaljen e artë në kategorinë 57 kilogramë. Kosova i dërgoi 11 atletë në Lojërat Olimpike në Tokio, prej të cilëve gjashtë ishin me normë olimpike. Duke e parë numrin e atletëve pjesëmarrës, rezultati i Kosovës vlerësohet të jetë fantastik.

## Kampionët vazhdojnë me fitore

**SUHAREKË, 5 DHJETOR** - Golden Eagle Ylli ka vazhduar me fitore, duke mundur Kamza Basket me rezultat 89:75 (30:21, 22:9, 16:24, 21:21), në kuadër të xhiros së pestë në Ligën Unike. Vendasit e nisën ndeshjen shumë më mirë, me një seri prej 12:2 dhe ishin vazhdimisht në epërsi, duke e fituar çerekun e parë me rezultat 30:21. Therandasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke e thelluar më shumë epërsinë, ku më e larta ishte 52:29, ndërsa pjesa e parë përfundoi me rezultat 52:30. Në periudhën e tretë ishte lojë më e barabartë, me



mysafirët që ngushtuan shifrat dhe e fituan këtë pjesë 16:24, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 68:54. Dhjetë minutat e fundit ishin tërësisht të barabartë dhe kjo bëri që Ylli të triumfojë me rezultat 89:75. Golden Eagle Ylli ka katër fitore dhe një humbje, kurse Kamza Basket ka dy fitore dhe tri humbje.



## Eliminohet Besa Famgas

**PRISHTINË, 5 DHJETOR** - Ndeshja e madhe e skuadrës Besa Famgas në Rumani. Por, megjithatë, tutje

shkon Turda rumune falë fitores prej tri golave dallim. Besa kishte fituar me dy gola dallim para një

jave. Besa kishte rastet e veta në fund, por që nuk i shfrytëzoi. I mungoi edhe fati, duke goditur dy

herë shtyllën, ndërsa edhe disa vendime të gjyqtarëve ishin të diskutueshme.

## Mourinho mund të rikthehet në Premierë Ligë

**ROMË, 5 DHJETOR** - Jose Mourinho është shfaqur si objektiv i mundshëm për Evertonin, nëse klubi anglez vendos të shkarkojë Rafa Benitezin, sipas "Mirror". Portugezi mori drejtimin nga Roma në korrik, por do të ishte i


gatshëm të rikthehej në Angli nëse paraqitej mundësia e duhur. Presioni ndaj Benitezit është rritur pas derbit Merseyside, në të cilin Everton u mund 4-1 nga Liverpooli në mesjavë. Kjo humbje e zgjati serinë e keqe të Evertonit në

shtatë humbje dhe dy barazime në 10 ndeshjet e fundit të Premierë Ligës. Tifozët vendas u mërzitën dhe përsëri e hoqën zemërimin e tyre mbi trajnerin dhe drejtuesit e "Goodison Park". Bashkëpronari Farhad Moshiri e ka mbështetur


publikisht Benitezin që atëherë, por vota e besimit do të zgjasë vetëm për një kohë nëse rezultatet nuk përmirësohen. Në rast se vendosin të bëjnë një ndryshim në stol, emri i Mourinhos është ai që tingëllon më shumë.







Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



03.12.2021

## Njoftim për tatimpagues

### Të ardhurat e gjeneruara nga kriptovalutat, janë të ardhura të tatueshme!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, se janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimin dhe Kontributet Pensionale.

**Me fokus të veçantë, ATK do të përqendrohet në identifikimin dhe trajtimin e personave, të cilët krijojnë të ardhura nga kriptovalutat.**

Për personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimet dhe Kontributet Pensionale, ATK do të ndër marrë masat sipas legjislacionit tatimor.

Administrata Tatimore e Kosovës, u bënë thirrje të gjithë personave që të deklarojnë të ardhurat e krijuara apo të korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tatimore, kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimit me standarde të larta, mirëqenien shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

*Pagesa e tatimit, siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend!*

Administrata Tatimore e Kosovës




# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT



# SWISS

## TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Esmir Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- V dhe VI- IX SHFMU "Fadil Hisari" Prizren
- ▶ Hamez Memqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Leke Dukagjini " Prizren
- ▶ Salajdin Susuri shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren
- ▶ Zafir Rexha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren
- ▶ Granit Berisha shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren
- ▶ Mergim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren
- ▶ Mimoza Pireci shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Leke Dugagjini" Prizren.
- ▶ Dhurata Selimi shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Fakultetit Filologjik në UP , dega Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.
- ▶ Petrit Këpuska Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH. M të Veterinarisë "Hysni Zajmi".
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

